



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ENERGJISË
DHE INDUSTRIË

DREJTORIA E POLITIKAVE DHE ZHVILLIMIT TE MINIERAVE

Nr. 8116

Tirane, date 15.12/2015

Drejtuar: Z.BESNIK BUSHI
SHOQERIA "RUBIN PETROL" SHA
URA VAJGURORE

BERAT

Për njoftim: Z. DAEL DERVISHI, DREJTOR EKZEKUTIV
AGJENCIA KOMBETARE E BURIMEVE NATYRORE
BULEVARDI "BAJRAM CURRI" BLOKU "VASIL SHANTO"

TIRANE

Z.RRAPUSH TOLA, DREJTOR
REPARTI INSPEKTIM-SHPETIMIT TE MINIERAVE
RRUGA "LORD BAJRON", LAPRAKE

TIRANE

Lënda: Njoftim për fillim procedurash revokimi te lejes nr.929 date 15.02.2006.

I nderuar z. Bushi,

Shoqëria "Rubin Petrol" sha është zotëruese e lejes minerare te shfrytëzimit nr.929 date 15.02.2006 për gurë gëlqeror , ne objektin "Guri i Bardhe", Ura Vajguore, ne Qarkun Berat.

Nga struktura përgjegjëse AKBN me shkresën nr. 8142 date 07.09.2015, protokolluar ne Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë (MEI) me nr.6025 date 08.09.2015, është propozuar revokimi i lejes minerare te shfrytëzimit nr.929 date 15.02.2006 për gurë gëlqeror , ne objektin "Guri i Bardhe", Ura Vajguore, ne Qarkun Berat , për arsye se nuk është paguar garancia financiare për rehabilitimin e Mjedisit siç është përcaktuar ne nenin 31, pika 5 te ligjit nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë" te ndryshuar, për vitin 2011-2012, vitin 2012 – 2013, vitin 2013 – 2014, vitin 2014 -2015 dhe vitin 2015-2016.

Leja juaj është dhëne me Ligjin nr.7796 date 17.02.1994 "Minerar te Shqipërisë" te ndryshuar qe është shfuqizuar me ligjin nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë", te ndryshuar.

Sipas nenit 57 pika 2 dhe 3 te ligjit nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë", te ndryshuar, përcaktohet shtrirja e efekteve edhe për lejet e dhëna përpara hyrjes ne fuqi te këtij ligji.

Leja juaj është dhëne për një afat fillestar për 10 vite dhe ky afat vlefshmërie mbaron me date 19.01.2016. Ne zbatim te pikës nr.6 te nenit 24 te ligjit nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë", te ndryshuar duhet te kishit aplikuar pranë Qendrës

Kombëtare të Licencimit, për zgjatjen e këtij afati edhe për 10 vite të tjera, 180 dite përpara përfundimit të afatit fillestar, gjë të cilën ju nuk e keni bere.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore për revokim është i mbështetur në germën “ç” të pikës 1 të nenit 47 (neni që përcakton shkeljet ligjore për të cilat një leje revokohet) të ligjit nr.10304 datë 15.07.2010 “Për sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Sa me sipër në zbatim të nenit 48 të ligjit nr.10304 datë 15.07.2010 “Për sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, **ju njoftojmë fillimin e procedurave të revokimit të lejes minerare të shfrytëzimit nr.929 datë 15.02.2006 për gurë gëlqeror , në objektin “Guri i Bardhe”, Ura Vajguore, në Qarkun Berat, që shoqëria juaj zotëron.**

Ju bëjmë me dije se pas një periudhe 30 ditore nga ky njoftim, do të merret vendimi për revokimin e lejes nr.929 datë 15.02.2006 për gurë gëlqeror , në objektin “Guri i Bardhe”, Ura Vajguore, në Qarkun Berat.

Në zbatim të nenit 49 të ligjit nr.10304 datë 15.07.2010 “Për sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë” duhet të rehabilitoni zonën e shfrytëzimit në të cilën keni ushtruar aktivitet minerar.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin

MINISTRI

DAMIAN GJIKNURI

